



Prishtinë, 19.11.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1455_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2253_10_21** i dt.21.10.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **08.11.2021**;

në seancën e mbajtur më datë 19.11.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si i pabazuar** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin F.Q me shifër DPZ – 9026431, nga Komuna e Prizrenit.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2253_10_21, i datës 21.10.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 21.10.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2253_10_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit F.Q dhe e ka obliguar KESCO-n që ta anulojë faturat e periudhave 03/04/2020 dhe se për këto periudha të faturohet me shpenzimet e regjistruara në periudha të njëjta 03/04/2021.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhat 03/04/2020 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor, sepse konsumatori ka krijuar lidhje direkte në një fazë para njehsorit dhe energjia e shpenzuar përmes kësaj lidhje nuk është matur.
- Fatura e muajit 04/2020 është më e lartë se faturat e periudhës së njëjtë të vitit paraprak dhe vitit vijues, por kjo nuk nënkupton se konsumatori nuk e ka shpenzuar energjinë e faturuar, pasi që leximet e bëra për këtë periudhë janë lexime me pajisje elektronike HHU, ku të dhënat janë marrë në mënyrë automatike “me sondë” dhe në këtë mënyrë është evituar gabimi në lexim.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2253_10_21 i datës 21.10.2021 për konsumatorin F.Q.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se korigjimi shtesë është në përputhshmëri me rregullat në fuqi, Bordi i ZRrE-së si të tillë e vlerëson si të paqëndrueshëm, për faktin se, duke u bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike si dhe listave të leximit, konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se në asnjë rast nuk janë evidentuar dëmtime të mundshme apo çrregullime të matjes për njehsorin elektrik. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhën kontestuese si dhe periudhat më të hershme dhe më të vonshme të njëjta kohore, ZRrE ka konstatuar se faturimi i periudhës 04/2020 nuk paraqet shpenzim real mujor te konsumatorit. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimet me njehsorin elektrik nr.63797562 për periudhën 04/2017 është **671 kWh/muaj**, periudhën 04/2018 është **588 kWh/muaj**, periudhën 04/2019 është **566 kWh/muaj** si dhe periudhën 04/2021 është **651 kWh/muaj**. Duke pasur parasysh se periudha 04/2020 nuk mund të paraqet shpenzim real mujor te konsumatori, listat e leximit, procesverbalet e inspektimit nr. 2280985 datë 24.03.2020, nr. 2263458 datë 04.05.2020 dhe nr. 2272660 datë 15.05.2020 DMK si shkallë e parë me të drejtë ka vendosur që konsumatorit duhet t'i anulohen faturat e periudhës 03/04/2020 dhe se për këto periudha të faturohet me shpenzimet e periudhës 03/04/2021.

Për më tepër, ZRrE ka gjetur se, shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit dhe ato të faturuara në CCP në periudhën 03/2020 nuk përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit, pasi që gjendjet e faturuara me datë 25.03.2020, siç edhe është elaboruar në vendimin kontestues janë të ndryshme.

Po ashtu, duke u bazuar në procesverbalet e inspektimit të dt. 15.05.2020 dhe 04.05.2020, ZRrE ka gjetur se punëtorët e autorizuar te KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kane evidentuar gjendjen e shpenzimeve ne njehsorin elektrik nr.63797562 ku TL=31530 kWh dhe TU=17166 kWh. Pasi që janë analizuar të dhënat e evidentuara në procesverbal, është konstatuar se shpenzimet e evidentuara ne tarifën e lartë janë me te ulëta se shpenzimet e evidentuara ne procesverbalin e inspektimit nr. 2263458 datë 04.05.2020 edhe përkundër faktit që inspektimi i dystë është bërë pas 10 ditëve.

Bazuar ne analizat e bëra, ZRrE konstaton se faturimi i konsumatorit është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1, dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji thuhet se: *1.Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjerë, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2.Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3.Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktajnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.*

Në pretendimin se konsumatori ka bërë shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, ZRrE thekson se, shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është vepër penale e përcaktuar me Kodin Penal të



Republikës së Kosovës, dhe rrjedhimisht, është në kompetencë të organeve të drejtësisë që ta trajtojnë çdo rast sipas legjislacionit në fuqi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit F.Q,
- Arkivit të ZRRE-së.